

# Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”

## Procesverbali i mbledhjes

Ref. 1/2010

**Vendi:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

**Data:** 2 dhjetor 2010

**Koha:** 11:00 – 12:10

**Pjesëmarrësit:**

**Robert Wright**, Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (*kryesues*)  
**Gjylfidane Kadrijaj**, Drejtore e Sistemeve Ndërbankare të Pagesave, BQK  
**Fatmir Rashica**, Specialist i Kontrollës së Pagesës, KEK  
**Milot Kelmendi**, Menaxher i Performancës dhe Analizës, KEK  
**Thomas Smith**, Këshilltar i USAID-it, KEK  
**Shyqri Krasniqi**, Menaxher Ekzekutiv i Shitjes, KUR Prishtina  
**Samir Lleshi**, Ekspert për çështje Fiskale dhe Financiare, OEK  
**Edmond Jashari**, Zyrtar i lartë i menaxhimit të marketingut, TEB  
**Ozenc Alkan Asik**, Udhëheqëse e Operacioneve Bankare, TEB  
**Avni Gashi**, Udhëheqës i Pagesave dhe për Bankat korrespondente, PCB  
**Teuta Gazideda**, Menaxhere e CM&TMO, RBKO  
**Arzen Çavderbasha**, Koordinator i zhvillimeve DSNP, BQK  
**Rinor Gjonbalaj**, Zyrtar i Mbikëqyrjes DSNP, BQK

*Përfaqësuesit e NLB dhe PTK munguan pa njoftim paraprak.*

Takimi u fillua në ora 11:00.

### **Diskutimet dhe prezantimet**

#### **Termet e Referencës dhe Objektivat e Projektit**

Z. Robert Wright prezantoi para përfaqësuesve Termet e Referencës të grupit menaxhues të projektit. Dy objektivat kryesore të projektit janë (i) për të përgatitur protokollat dhe mundësisht rregullat për veprimet dhe masat që duhen ndërmarrë nga bankat, komuniteti i biznesit dhe individët privatë për reduktimin e vëllimit të transaksioneve në para të gatshme, dhe (ii) për të

arritur konsensus ndërmjet bankave, me qëllim të nënshkrimit dhe zbatimit të protokollit dhe rregulloreve.

Z. Wright vlerësoj se është jetik pjesëmarrja e komunitetit të biznesit në zhvillimin e projektit dhe implementimin e tij. Ndryshimi i legjislacionit është i vështirë dhe merr kohë prandaj ekipi menaxhues i projektit duhet të fokusohet tek vendosja apo ndryshimi i kodit të sjelljes së akterëve.

*(Shih Termat e Referencës të bashkangjitura)*

### **Prezantimi i situatës aktuale për pagesa cash dhe jo-cash në Kosove**

Znj. Gjylfidane Kastrati-Kadrijaj prezantoi para përfaqësuesve situatën aktuale të pagesave cash dhe jo-cash në Kosovë, përfshirë rolin e BQK-së, funksionimin e skemave Kos-Giro dhe Debitim Direkt, objektivat strategjike dhe bazën ligjore. Znj. Kastrati-Kadrijaj u ndal tek numri dhe vlera e pagesave në cash dhe jo-cash brenda bankare, ndërbankare dhe ndërkombëtare, duke potencuar se numri i pagesave në cash ende vazhdon të mbetet i lartë.

*(Shih prezantimin e bashkangjitur)*

### **Çështjet tjera dhe diskutime me përfaqësuesit e projektit**

Përfaqësuesi i OEK (Samir Lleshi) vlerësoj se duhet të shikohen implikimet e ligjeve në numrin e pagesave cash dhe jo-cash (p.sh. ligji për TVSH). Nga këndi i komunitetit të bizneseve vlerësoj se disa nga shërbimet e pagesave të bankave komerciale vazhdojnë të jenë të larta dhe jo-stimuluese për përdorim të gjerë nga bizneset. Rreth pagesave Kos-Giro dhe ndryshimit të faturave, u qartësua nga pjesëmarrësit se ky ndryshim mund të ndodhë nëse kjo parashihet në marrëveshjen bankë - kompani. P.sh. tek pagesat Kos-Giro të KEK-ut mund të ndryshohet fatura dhe të paguhet një shumë tjetër nga klienti.

Përfaqësuesit e KEK-ut (Thomas Smith) treguan se disa nga problemet kryesore të tyre janë (i) vetëm 50% të klientëve kanë me vete faturën Kos-Giro në momentin e pagimit të faturës (*është e domosdoshme fatura në rast të pagesës përmes bankës*), (ii) edhe paguesit e rregullt nuk paguajnë çdo muaj por çdo 2 apo 3 muaj. Një zgjidhje për këto probleme është përdorimi i **Debitimit Direkt** nga ana e klientit. Përmes kësaj skeme klientit i debitohet llogaria bankare çdo muaj në mënyrë automatike, dhe nuk ka nevojë për faturë apo prezencë fizike të klientit.

Rreth disa çështjeve operacionale të ngritura nga KEK-u (Milot Kelmendi), ato do të trajtohen në takime individuale apo në takimin e rregullt të radhës të Komitetit Këshillëdhënës të Pagesave Ndërbankare (KKPN)<sup>1</sup>. Çështjet ditore operacionale nuk parashihet të trajtohen në punën e ekipit menaxhues për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”.

---

<sup>1</sup> Gjatë hartimit të procesverbalit të mbledhjes, përfaqësuesit e KEK-ut janë kontaktuar rreth kësaj çështjeje.

## Konkluzionet Takimit dhe Hapat e ardhshëm

- Përfaqësuesit në ekipin menaxhues të projektit duhet të vijnë rregullisht dhe me kohë në takime, dhe preferohet që të nominuarit të jenë të njejtë gjatë gjithë punës së ekipit. Për pjesëmarrjen në takime të personave që nuk janë nominuar në ekipin menaxhues, duhet paraprakisht të njoftohet organizuesi i takimit.
- ***Në takimin e punës së radhës (“roundtable”), për arsye të hapësirës dhe të akomodimit, le të marrin pjesë vetëm nga një përfaqësues nga institucioni në takim (sipas listës së dorëzuar nga SHBK dhe përfaqësuesve të nominuar nga kompanitë utilitare).***
- BQK do të mbledh të dhënat e nevojshme statistikore rreth pagesave nga shtetet e Evropës Qendrore (si Hungaria dhe Republika Çeke) dhe nga ato të Evropës Juglindore. Të dhënat nga Kosova, si raporti i transaksioneve për një ATM, numri i kartelave për 100,000 banorë, etj., do të krahasohen me shtetet e tjera. Si synim për arritje duhet të jenë shtetet e Evropës Qendrore.
- Analiza e kostove dhe përfitimeve do të shtyhet për më vonë.
- Z. Robert Wright do të gjejë përafërsisht sa kushton organizimi i një hulumtim mbi Klientin dhe Tregtarin dhe për të kuptuar çështjet e tyre në lidhje me pagesat jo-cash. Ekipi menaxhues do të vendosë nëse është e nevojshme dhe e vlefshme kryerja e këtij hulumtimi.
- Më 8 dhjetor në ora 10:00 - 12:00, në ndërtesën e Odës Ekonomike të Kosovës do të mbahet një prezantim për përdorimin e mënyrave të reja të pagesave pa para të gatshme, i organizuar nga BQK dhe OEK. Anëtarët e ekipit menaxhues janë të mirëseardhur.

## Propozime nga BQK për takimin e ardhshëm<sup>2</sup>

1. Marrja e iniciativave dhe aktiviteteve konkrete për reduktim të pagesave në cash nga të gjitha institucionet (banka komerciale, kompani publike, kompani private, agjenci qeveritare, etj.) Si psh. Kompanitë utilitare të hartojnë plane operative për zvogëlim/mbyllje të arkave/sportelevë të tyre që pranojnë cash. *(Vendosja e afateve kohore është i nevojshëm).*<sup>3</sup>
2. Nga Bankat Komerciale të zvogëlohen tarifat për shërbimet e pagesave elektronike, si Debitim Direkt, E-Banking, Kos-Giro, etj. Besojmë se të hyrat e humbura nga zvogëlimi i tarifave do të kompensohen me rritjen e numrit të pagesave.
3. Të analizohen praktikat në vendet e tjera të vendosjes së limiteve maksimale për vlerat e pagesave në cash pranë sporteleve të bankave komerciale, dhe të dilet me rekomandime për insitucionet e Qeverisë (MEF).

---

<sup>2</sup> Këto propozime do të diskutohen në takimin e radhës (26 janar 2011).

<sup>3</sup> Kjo çështje është biseduar me zyrtarët e KEK-ut në takimet në BQK gjatë zhvillimit të skemës së Debitimit Direkt.